

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

## MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

### KUALIFIKIMI PROFESIONAL “SHËRBIME MJETESH TRANSPORTI”

#### Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

#### Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30		
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

- 
1. Në motorin me katër kohë, boshti me gunga, për një cikël pune kryen: **1 pikë**
- A) 1 rrotullim të plotë;
  - B) 2 rrotullime të plota;
  - C) 3 rrotullime të plota;
  - D) 4 rrotullime të plota;
2. Shtytësit hidraulikë në mekanizmin e gazshpërndarjes: **1 pikë**
- A) komandohen nga qafat e bangove të boshtit motorik;
  - B) komandohen nga presioni i gazit në bllokun e cilindrave;
  - C) realizojnë kontaktin me valvulen, me goditje;
  - D) nuk kanë nevojë për rregullim të hapësirës së temperaturës;
3. Sistemit i ftohjes me lëng, i motorit është: **1 pikë**
- A) i hapur;
  - B) i mbyllur;
  - C) me spërkatje;
  - D) me vetërrjedhje;
4. Valvula e presionit në sistemin e vajosjes: **1 pikë**
- A) filtron vajin në sistem;
  - B) rrit presionin në sistem;
  - C) hapet nga presioni i lartë në sistem;
  - D) hapet nga presioni ulët në sistem;
5. Gazrat që kalojnë në karterin e motorit: **1 pikë**
- A) zvogëlojnë konsumimin e cilindrit;
  - B) rrisin presionin në karter;
  - C) përmirësojnë formimin e përzierjes së djegëshme;
  - D) përmirësojnë lubrifikimin e cilindrit;
6. Në raportin ajër/lëndë djegëse të përzierjes së djegëshme, ndikon: **1 pikë**
- A) diametri i cilindrit
  - B) forma e kokës së pistonit;
  - C) koeficienti i ajrit të tepërt;
  - D) koeficienti i shkëmbimit të gazit;
7. Aftësia për të mos patur detonacion është një veti shumë e rëndësishme e: **1 pikë**
- A) benzinës;
  - B) naftës;
  - C) gazit GPL;
  - D) hidrogjenit;

8. Në motorin me naftë me komandim elektronik, përzjerja e djegshme ndizet nga: **1 pikë**
- A) kandelet e ndezjes;  
B) ngjeshja;  
C) avujt e lëndës djegëse;  
D) shkëndija elektrike;
9. Turbokompresori vihet në lëvizje nga: **1 pikë**
- A) presioni i ajrit gjatë lëvizjes së mjetit;  
B) boshti me gunga;  
C) motori elektrik;  
D) presioni i gazit të shkarkimit;
10. Elektroliti i baterisë është një përzjerje e: **1 pikë**
- A) acidit sulfurik dhe acidit klorhidrik;  
B) acidit sulfurik dhe etilenglikolit;  
C) acid sulfurik dhe ujit të distiluar;  
D) acid klorhidrik dhe ujit të distiluar;
11. Me rritjen e shpejtësisë së boshtit motorik, avanca e ndezjes së përzjerjes së punës duhet të: **1 pikë**
- A) zmadhohet;  
B) mbetet e pandryshuar;  
C) zvogëlohet me 5 gradë;  
D) zvogëlohet ndjeshëm;
12. Sonda "lambda" i jep informacion njësisë kontrolluese (ECU) mbi përqendrimin e: **1 pikë**
- A) CO në gazrat e shkarkimit;  
B) CO<sub>2</sub> në gazrat e shkarkimit;  
C) O<sub>2</sub> në gazrat e shkarkimit;  
D) O<sub>2</sub> në kolektorin e thithjes;
13. Elementi që ndryshon në madhësi momentin rrotullues dhe e transmeton atë nga boshti kardanik në diferencial është: **1 pikë**
- A) boshti me gunga;  
B) xhunto kardanike;  
C) gjysmëboshti;  
D) çifti koronë-pinjon;
14. Lidhur me emërtimin e gomës të paraqitur më figurë, pohimi i saktë është: **1 pikë**
- A) diametri i saj i jashtëm është 19 inch;  
B) shkronja "R" tregon "rrezen e gomës";  
C) lartësia anësore është 55% e gjerësisë së gomës;  
D) data e prodhimit të saj është 03.06.2011;



15. Sistemi i frenimit me "electronic stability program" (ESP) realizon: 1 pikë
- A) korrigjimin e trajektores së mjetit edhe kur të 4 rrotat kanë kapje (kontakt) të vogël me rrugën;  
 B) bllokimin e rrotave gjatë frenimit në rrugë me kthesa të forta;  
 C) korrigjimin e trajektores së mjetit kur rrotat kanë kapje të ndryshme me rrugën;  
 D) rrotullimin e plotë të mjetit në vend;
16. Elementi që kontrollohet nga sistemi i diagnostikimit në bord (EOBD) është: 1 pikë
- A) rregullatori i alternatorit;  
 B) moduli hidraulik i sistemit ESP;  
 C) friksioni automatik i kutisë së shpejtësisë;  
 D) sonda lambda e sistemit të shkarkimit të gazrave;
17. Lidhur me llambën halogjene të paraqitur më figurë, pohimi i saktë është: 1 pikë
- A) gazi halogjen që rrethon filamentin e tungstenit është jod dhe brom;  
 B) gazi halogjen ul temperaturën filamentit;  
 C) gazi halogjen ul nivelin e ndriçimit të llambës;  
 D) llampa halogjene funksionon me rrymë alternative;
- 
18. Sensori i goditjeve (detonacionit): 1 pikë
- A) vendoset në bllokun e cilindrave;  
 B) vendoset në kokën e motorit;  
 C) përcakton cilësinë e lëndës djegëse;  
 D) përcakton pastërtinë e ajrit;
- 
19. Sistemi Stop & Start i motorit të automjeti: 1 pikë
- A) përdoret vetëm në automjetet me kuti shpejtësie automatike;  
 B) funksionon edhe kur automjeti është në lëvizje;  
 C) funksionon në çdo temperaturë të punës së motorit;  
 D) funksionon edhe kur filtri DPF është në modalitetin e rigjenerimit;
20. Bobina e sistemit të ndezjes është një: 1 pikë
- A) stabilizues i energjisë elektrike;  
 B) transformues i tensionit të energjisë elektrike;  
 C) rregullues i rrymës elektrike;  
 D) grumbulles i energjisë elektrike;


21. Listoni katër nga arsyet më kryesore pse sistemi i injektimit direkt të lëndës djegëse, te motorët diesel, funksionon në presion shumë të lartë:

4 pikë

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

22. Në skemën e sistemit të frenimit me ABS, emërtoni elementët:

4 pikë



Elementi 1: \_\_\_\_\_

Elementi 2: \_\_\_\_\_

Elementi 4: \_\_\_\_\_

Elementi 5: \_\_\_\_\_

23. Në skemën e sistemit të frenimit me ABS më sipër tregoni 4 detyrat që kryen Elementi 3 (Njësia kontrolluese - ECU):

4 pikë

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

24. Në secilin nga pohimet e mëposhtme vendosni e vërtetë (V) ose e gabuar (G):

4 pikë

- a) Rendimenti i motorit është raporti ndërmjet punës mekanike të fituar dhe energjisë së harxhuar. \_\_\_\_\_
- b) Rendimenti mund të jetë 0 (zero) \_\_\_\_\_
- c) Humbja e energjisë është ndryshimi midis fuqisë hyrëse dhe energjisë dalëse. \_\_\_\_\_
- d) Rendimenti i motorit zvogëlohet me rritjen e forcave të fërkimit. \_\_\_\_\_

25. Listoni 4 detyrat kryesore që kryen sistemi i shkarkimit të gazrave të motorit:


4 pikë

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_



26. Në skemën e motorit me benzinë, me injeksion direkt, për pohimet e mëposhtme, rrethoni PO për përgjigjen e saktë dhe JO për përgjigjen e gabuar:

4 pikë



- a) Ky sistem injektimi quhet "injeksion me një pikë".
- b) Skema tregon injektimin gjatë kohës së thithjes.
- c) Elementi «5» mat normën e NOx në gazrat e shkarkimit.
- d) Elementi «1» e rrit presionin e benzinës 50 deri në 200 bar.

PO	JO
PO	JO
PO	JO
PO	JO

27. Në figurën e mësipërme, emërtoni elementët:

4 pikë

- Elementi 1: \_\_\_\_\_
- Elementi 2: \_\_\_\_\_
- Elementi 3: \_\_\_\_\_
- Elementi 6 : \_\_\_\_\_

28. Për sensorët e automjeteve, plotësoni vendet bosh në fjalinë e mëposhtme:

4 pikë

a) Sensorët e automjeteve, dukuritë \_\_\_\_\_ i shndërrojnë në sinjale \_\_\_\_\_.

b) Sinjalet elektrike të sensorëve transmetohen te \_\_\_\_\_ që, në përputhje me programin e instaluar, aktivizon \_\_\_\_\_.

29. Listoni 4 detyrat kryesore që realizon kutia e ndërrimit të shpejtësisë (KNSH):

4 pikë

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_



30. Listoni katër nga shenjat kryesore që tregojnë parregullsitë e funksionimit të sensorit të temperaturës së lëngut ftohës në sistemin e ftohjes së motorit:

4 pikë

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_



